Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

♦ **Njoftimi i Fituesit**

- Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

♦ **Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës**

- ♦ Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
- ♦ Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një

nga format e mëposhtme:

- i. mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- ii. garanci bankare
- iii. garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

♦ **Procedura e ankesës**

- Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
- Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

- Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

♦ Anulimi i procedurës

i. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

ii. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

iii. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

iv. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit

dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijoje me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës

1	2		3	4	5
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)
1	Rinovimi i licensës së sistemit egzistues antivirus Check Point SandBlast Agent për 2 vite (400 përdorues)	Set	1		
2	Rinovimi i licensës së sistemit egzistues antivirus me XDR dhe XPR per 2 vite (400 perdorues)	Set	1		
3	Vulnerability Scanner Management	Set	1		
4	Instalimi dhe konfigurim	Set	1		
Çmimi total					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

“Upgrade i sistemeve të sigurisë të antivirus dhe email”.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njëzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas përcaktimeve të bëra në Termat e References.

1	“Upgrade i sistemeve të sigurisë të antivirus dhe email”.			24 (njëzet e kater) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.
---	---	--	--	---

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

1.2. Historiku

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar me datë 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare në tre shoqëri të veçanta. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

1. Furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
2. Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
3. Tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit;

2. Qëllimi

Rritja e rreziqeve të shkaktuara nga malware, ransomware dhe sulmeve të sofistikuar të inxhinierisë sociale ka bërë që përdoruesit fundorë të jenë një pikë hyrëse e përhapur për kërcënimet kibernetike ndaj kompanisë. Këto sulme mund të jenë të fshehura në përmbajtjen e navigimit në internet, bashkëngjitur me postën elektronike (*email*), pajisjet e memorjes së jashtme të lëvizshme (*usb*) ose nga shprehendardet në rrjet. Punonjësit pa vetëdije, mund të bëhen viktimat e sulmeve të tilla duke rezultuar në humbje të konsiderueshme financiare, thyerje e sigurisë së të dhënave apo shkatërimin e tyre si dhe e humbjes së produktivitetit. Edhe veprimet me të thjeshta të punonjësve në ripërdorimin e kredencialeve dhe fjalëkalimeve të kompanisë për veprime që nuk kanë lidhje me biznesin mund të vendosin komaninë përballë riskut. Gjithashtu, me shtimin e numrit të shërbimeve të ndryshme për punonjësit të cilët përdorin pajisjet e kompanisë me kontroll në distance apo dhe me shtimin e kontraktorëve dhe konsulentëve të cilët sjellin sistemet e tyre në kompani, kriminelët kibernetik i etiketojnë dobësitë në sigurinë e përdoruesit fundor për tu infiltruar dhe infektuar sistemet që punonjësit përdorin.

Parandalimi i humbjes së të dhënave është një nga mjetet më të rëndësishme të sigurisë së informacionit. OST sh.a. është një korporatë e një rëndësie të vecantë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajton një sasi shumë të madhe të dhënash sensitive. Të dhëna të cilat janë sensitive, individuale, kontraktore, institucionale dhe ndërkombëtare. Si të tilla këto të dhëna duhet të klasifikohen, mbrohen dhe ruhen sipas standarteve më të mira në fushën e sigurisë së informacionit.

Për të parandaluar rritjen e rreziqeve të mundshme, duhet të realizohet rinovimi i licensës së sistemit egzistues antivirus Check Point SandBlast Agent i cili është i integruar së bashku me

xdr/xpr dhe mbrojtje ndaj shërbimeve të office 365. Të gjitha shërbimet e mbrojtjes duhet të jenë të integruara në *cloud* në një konsolë të vetme.

3. Objekti

Për të siguruar mbrojtjen e sistemeve informatike, OST sh.a. ka të implementuar një sistem të qëndërzuar në *cloud* për parandalim të viruseve, programeve të dëmshme si dhe të integruar me (*XDR/XPR*). Ky sistem është i ndërtuar për të funksionuar në mënyrë të centralizuar dhe i aftë për të ndërtuar politika të përgjithshme të parandalimit, monitorimit, kontrollit të viruseve si dhe të kontrollit të përdorimit të pajiseve të jashtme si USB të cilat përbëjnë një rrezik të lartë infektimi si dhe të rrjedhjes së informacionit

Për të mundësuar këtë OST sh.a. kërkon të rinovoj licensën e sistemit egzistues antivirus Check Point SandBlast Agent për 350 përdorues, 50 përdorues të cilët duhet të përfshijnë enkriptimin e diskut, 400 përdorues ku të përfshihet *xdr/xpr* si dhe.

Të gjitha këto shërbime aktualisht janë të integruara në një konsolë të vetme menaxhimi.

4. Infrastruktura aktuale

Aktualisht në sistemin e saj, OST ka të instaluar sistemin *Check Point SandBlast* në pajisje Server, Desktop si dhe Laptop. Pajisjet të tipit desktop dhe laptop kanë të instaluar një agjent i cili menaxhohet nga një sistem i qëndërzuar në *cloud* *Checkpoint Harmony Endpoint*, *Check point Infinity XDR/XPR* ku një pjesë bëjnë të mundur dhe enkriptimin e plotë të diskut (*full disc encryption*)

Përshkrimi Teknik	
Funksionalitetet bazë të sistemit antivirus aktual	- Anti-malware - Anti-Ransomware - Anti Bot and Url Filtering
	- Threat Emulation and Anti Exploit - Media Encryption and Port Protection - Firewall and Application Controll - Zero-Phishing
	- Patch Assessment - SandBlast Agent - multiple platform support (Windows/Mac) - Host Intrusion Prevention (HIPS)

Karakteristikat e detajuara të sistemit aktual Antivirus:

Përshkrimi Teknik

Karakteristikat e detajuara të sistemit aktual	- Threat Emulation: Teknologji e perparuar rezistente - Threat Extraction: Skanon te gjitha filet e perdoruesit ne kohe reale - Anti-ransomware: Parandalon dhe reagon ndaj sulmeve Ransomware - Zero-Phishing: Bllokoi webfaqet mashtruese dhe te njofton kur riperdoret fjalekalimi - Anti-Bot: Identifikon dhe reagon ndaj host-eve te infektuara - Anti-Exploit: Mbron aplikacionin nga sulmet ndaj pikave te dobta te tij. - Behavioral Guard: Gjen dhe bllokoi veprimet sulmuese ndaj perdoruesit - Endpoint Antivirus: Mbrotje ndaj viruseve te njohura - Forensics: Ruan dhe analizon cdo ngjarje per te siguruar mbrotjen maksimale ndaj sulmeve
--	--

Perskrimi Teknik	
Analizimi i veprimeve te ndodhura	Procesi i testimit fillon automatikisht analizimin e ngjarjes sulmuese te ndodhur duke perdorur nje kombinim te algoritmeve te perparuara dhe nje analize te thelle te te dheneve te paperpunuara qe jane mbledhur, ajo nderton nje permbledhje te plotë te incidenteve. Permbledhja perbehet nga nje perskrim i detajuar te sulmuesit, ku perfshihen: Malicious events — Cfare informacionesh jane mbledhur gjate gjithë procesit te sulmit te ndodhur Entry point — Si mundi virusi te hyj ne rrjet. Cilat ishin elementet kryesorë qe u perdoren per kete sulm kibernetik. Si filloi sulmi. Damage scope — Cfare beri virusi qe nga momenti I aktivizimit te tij? Cfare problemesh mund ti sillte korporates. Cilat ishin te dhënat qe mund te merrte. Infected hosts — Kush ose cfare mund te jetë infektuar tjeter.

	Kjo gjithëpërshirje për të gjetur në mënyrë korrekte dhe të detajuar informacione mbi sulmin që kemi marrë mund të përmiresohet. Administratorët e sistemit dhe ekipet e mbrojtjes ndaj sulmeve mund të trajtojnë në mënyrë efikase dhe të zgjidhin sulmet, duke e rikthyer komanin tuaj në gjendjen për të vazhduar punën. Me anën e SmartEvent, korporata juaj do të jetë në gjendje të shohë të përmbledhura në raporte të gjitha eventet e ndodhura gjatë punës së kryer. Këto raporte ofrojnë analizë të sakte të incidenteve, duke përshpejtuar procesin e të kuptuarit të ciklit jetësor të plotë të sulmit dhe demtimet që janë shkaktuar gjatë tij.
--	--

Pershkrimi Teknik	
	Menaxhimi i Centralizuar i Cënueshmërive dhe Patch-eve: Skanim i automatizuar i sistemeve operative dhe aplikacioneve të instaluar. Zbulim i cënueshmërive të sigurisë në sistemin operativ dhe aplikacionet e instaluar.
Menaxhimi i Vulnerabiliteteve	Prioritizim i cënueshmërive të zbuluara. Instalimi i centralizuar i patch-eve për të zgjidhur cënueshmëritë e identifikuara.

--	--

Përveç sistemit aktual antivirus, OST ka të integruar brenda të njëjtës konsole një sistem *XDR/XPR*. Kjo zgjidhje është jetike për të funksionuar brenda mjedisit IT të OST, zgjidhje e cila ofron mbrojtje me shumë shtresa, duke vepruar para dhe pas një infektimi për të bllokuar malware të avancuar në kohë reale. Duke qenë se aktorët e kërcënimit nuk mund të ndalohen gjithmonë nga hyrja në rrjet, kjo zgjidhje që jo vetëm parandalon eksfiltrimin dhe zbulon të dhënat kritike gjatë një sulmi kibernetik, por gjithashtu përdor teknika unike për të bllokuar vetëm komunikimet me qëllime malinje, duke lejuar punonjësit të vazhdojnë punën e tyre normalisht edhe në raste të infektimit të pajisjeve.

Kërkesat teknike më të detajuara të zgjidhjes aktuale *XDR/XPR* që OST ka në operim:

Kërkesat Teknike	
XDR/XPR i gjeneratës së re	Zgjidhja aktuale është e integruar me një threat intelligence database për të gjetur trafikun kërcënues me latencë minimale. Kërcënimet e njohura duhet të identifikohen shpejt, duke reduktuar sasinë e punës për teknologjitë machine-learning dhe AI. Asistent i integruar me inteligjencë artificiale (AI Copilot)
	Zgjidhja aktuale përfshin Threat Intelligence për të shmangur nevojën për të bërë fillimisht një 'baseline' të trafikut ekzistues të rrjetit. Zgjidhja është në gjendje të gjejë kërcënime dhe trafik të rrezikshëm menjëherë pas implementimit.
	Nëse bëhet mësimi ose 'baselining' i trafikut ekzistues, zgjidhja është në gjendje të gjejë kërcënime dhe trafik të rrezikshëm gjatë periudhës së baseline. Kjo është e nevojshme në rastin që rrjeti është nën sulm gjatë periudhës së mësimi.

	Zgjidhja aktuale pasuron ndërfaqen me detaje të sulmeve dhe kërcënimeve. Kur një kërcënim është theksuar, jemi në gjendje të shohim më shumë detaje rreth tij për të siguruar që është një kërcënim real dhe për të kuptuar më shumë rreth aftësive dhe arritjeve të tij.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të analizojë nëpërmjet shumë vektorëve të kërcënimit dhe e projektuar për të përballur me të gjithë vektorët e kërcënimit, në vend që të përqendrohet kryesisht vetëm në ngjarjet e <i>endpoint</i> duke përdorur inteligjencë artificiale për lidhjen e ngjarjeve, të pasuruar edhe me burime të jashtme të inteligjencës së kërcënimeve.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të analizojë ngjarjet e endpoint. Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të analizojë ngjarjet nga zgjidhjet e mbrojtjes së zakonshme të Endpoint
	Zgjidhja aktuale është e aftë të analizojë trafikun e rrjetit, ku duhet të jetë në gjendje të analizojë trafikun e rrjetit për të gjetjene lidhjeve kërcënuese dhe modele kërcënuese nëpër lidhje të shumta.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të trafikun e email-it. Zgjidhja është në gjendje të analizojë trafikun e email-it për të gjetur fushata kërcënuese të email-it.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të ofrojë analiza të konsoliduara dhe të korrelojë nëpër të gjithë vektorët e kërcënimit për të shfaqur kontekstin e plotë.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të ofrojë një pamje të konsoliduar për çdo incident duke hartografuar taktikat dhe teknikat e <i>MITRE ATT&CK</i> të përfshira në incident.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të krijojë <i>IOCs</i> nga analiza dhe të gjejë modele të aktivitetit të rrjetit, <i>endpoint</i> dhe email-it që përbëjnë një kërcënim, pastaj të krijojë <i>IOCs</i> të veprueshme që mund të përdoren për të bllokuar raste të ardhshme të të njëjtit sulm ose sulmeve të ngjashme.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të duhet të ofrojë një menaxhim qendror për e <i>Indicators of Compromise (IoCs)</i> nga të gjitha produktet e integruara. Zgjidhja lejon krijimin e <i>feeds</i> të personalizuar nga burime të ndryshme dhe i kombin ato në një <i>feed</i> të vetëm, të lehtë për t'u aksesuar. Gjithashtu mbështet lidhjet me <i>live feeds</i> eksterne si dhe zbatimin e automatizuar mbi produktet e integruara. Mbështetë integrimin me sisteme të palëve të treta duke mbështetur eksportimin e përditësuar të <i>feed</i> të <i>IOC</i>.

	Zgjidhja aktuale është e aftë të ofrojë veprime automatike të marrjes së masave në të gjitha produktet e lidhura. Zgjidhja duhet të ofrojë veprime automatike të masave të marra për të hequr kërcënimet dhe të bëjë rekomandime për të parandaluar përsëritjen e tyre.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të ofrojë menaxhimin e incidenteve. Si dhe të ofrojë një metodologji për të menaxhuar incidentet nga zbulimi deri te zgjidhja dhe mbyllja e tyre.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të ofrojë aftësinë për <i>Threat Hunting</i> . dhe ofron mundësinë për të kërkuar manualisht kërcënime dhe për të zbuluar ku në infrastrukturë ato mund të jenë.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të mbështesë <i>API</i> për eksportimin e incidenteve dhe të dhënave forenzike në sisteme të jashtme.
	Zgjidhja aktuale është e aftë të mbështesë <i>API</i> për të kërkuar të dhëna nga <i>Threat Hunting</i> dhe për të marrë informacion rreth ngjarjeve të raportuara nga pajisjet <i>endpoint</i> .
	Të gjitha të dhënat e incidenteve, përfshirë të dhënat e papërpunuara forenzike, ruhen për një periudhë minimale prej 2 vitesh.
	Zgjidhja aktuale realizon krijimin e veprimeve automatike përmes <i>playbooks</i> ku përfshin integritet të ndryshme me sisteme të brendshme dhe të jashtme për të maksimizuar efikasitetin dhe reagimin ndaj kërcënimeve si psh. Teams, Slack dhe email etj.

Tabela Përmbledhëse

NR	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA
1	Rinovimi i licensës së sistemit egzistues antivirus Check Point SandBlast Agent për 2 vite (400 përdorues)	set	1
2	Rinovimi i licensës së sistemit egzistues antivirus me XDR dhe XPR për 2 vite (400 përdorues)	set	1
3	Vulnerability Scanner Management	set	1
4	Instalimi dhe konfigurim	set	1

Shenim:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard nderkombetar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshiruar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të balanceve ku të paktën në dy balance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 5,000,000 (pesë milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për sistemin antivirus. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001: për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, objekti i së ciles të kete lidhje me objektin e prokurimit.
- ISO 27001: për menaxhimin e sigurisë së informacionit, objekti i së ciles të kete lidhje me objektin e prokurimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, prej të paktën 3 (tre) muaj të fundit nga data shpalljes të njoftimit të kontratës:

- minimumi 1 (një) specialist të certifikuar për endpoint security protection ose ekuivalent.
- minimumi 1 (një) specialist të certifikuar për sigurinë e e-mail dhe (Collaboration) ose ekuivalent.

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

Për këto, OE ofertues duhet të disponojë kontratën e punës me punonjës të kërkuar, listepagesat përkatëse për periudhën e kërkuar si dhe certifikimet e punonjësve.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin si prova paraprake formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 10 “Formulari për mbledhjen e vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratores të shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmenden “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- Kudo në Dokumentet e Tenderit ku është cituar standard ndërkombëtar, do të pranohet edhe cilësim

ekuivalent nga një institut vendor.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Informacione për nënkontraktorin

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

